

TERMA DHE KUSHTE PËR GAREN PROMOCIONALE "Fito Bileta për Koncertin e Kanye West"

1. Organizatori

Kjo garë promovionale ("Gara") organizohet nga IutePay SHPK ("Organizatori"), me seli në Tiranë, Shqipëri.

2. Periudha e Garës

Gara zhvillohet nga data 1 Qershor 2026 deri më 30 Qershor 2026, ora 23:59 ("Periudha e Garës").

Fituesit do të shpallen më 1 ose 2 Korrik 2026 nëpërmjet kanaleve zyrtare të Organizatorit.

3. Kush Mund të Marrë Pjesë

Në Garë mund të marrin pjesë vetëm personat që plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Janë të moshës 18 vjeç ose më të madhe në momentin e pjesëmarrjes;
- Janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë;
- Kanë kapacitet të plotë ligjor për të vepruar;
- Plotësojnë kushtet e pjesëmarrjes të përcaktuara në këto Terma dhe Kushte.

Nuk lejohen të marrin pjesë:

- Punonjësit e Organizatorit;
- Punonjësit e agjencive ose partnerëve të përfshirë në organizimin e Garës;
- Bashkëshortët/partnerët, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat dhe familjarët e afërt të personave të mësipërm.

4. Mekanizmi i Garës

Për t'u kualifikuar për Garën, pjesëmarrësi duhet të përmbushë të dy kushtet e mëposhtme gjatë Periudhës së Garës:

1. Të hapë për herë të parë llogarinë IUTE (Myiute) gjatë periudhës së fushatës;
2. Të kryejë të paktën pesë (5) transaksione te partnerët e përcaktuar nga Organizatori gjatë periudhës së fushatës.

Lista e partnerëve pjesëmarrës dhe ofertat përkatëse do të publikohen dhe komunikohen nga Organizatori përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.

Vetëm pjesëmarrësit që përmbushin të dy kriteret e mësipërme do të konsiderohen të vlefshëm për përzgjedhjen e fituesve.

5. Përzgjedhja e Fituesve

Në përfundim të Garës do të shpallen tre (3) fitues.

IutePay shpk
NIPT: M022090020

 Rr. "A.Z.ÇAJUPI" 1001 TIRANA
ND.3, H.2 ALBANIA

 **iute.al**
044 50 50 60

- Fituesit do të përzgjidhen ndër pjesëmarrësit që kanë përmbushur kushtet e Garës dhe që kanë realizuar numrin më të lartë të transaksioneve të vlefshme gjatë Periudhës së Garës.
- Në rast barazimi në numrin e transaksioneve, Organizatori rezervon të drejtën të përdorë kritere shtesë verifikimi për përcaktimin e fituesit.
- Vendimi i Organizatorit lidhur me fituesit është përfundimtar dhe nuk mund të ankimohej.
- Fituesit do të kontaktohen nëpërmjet numrit të telefonit, adresës së emailit ose kanaleve të tjera të kontaktit të regjistruara pranë Organizatorit.
- Nëse një fitues nuk përgjigjet brenda afatit prej 5 (pesë) ditësh kalendarike nga momenti i kontaktimit, Organizatori rezervon të drejtën të përzgjedhë një fitues tjetër.

6. Çmimi

Çmimi përbëhet nga:

- Tre (3) bileta për koncertin e Kanye West, nga një biletë për secilin fitues.

Çmimi:

- Nuk mund të transferohet te një person tjetër;
- Nuk mund të shkëmbehet me para në dorë ose ekuivalent monetar;
- Nuk mund të zëvendësohet me një çmim tjetër, përveç rasteve kur Organizatori e konsideron të nevojshme për arsye të pavarura prej tij.

Organizatori nuk mban përgjegjësi për anulimin, shtyrjen ose ndryshimin e eventit nga organizatorët e koncertit.

7. Skualifikimi

Organizatori rezervon të drejtën të skualifikojë menjëherë çdo pjesëmarrës që:

- Jep informacion të rremë ose të pasaktë;
- Përdor profile, llogari ose identitete të rreme;
- Manipulon ose tenton të manipulojë mekanizmin e Garës;
- Kryen veprime mashtruese ose abuzive;
- Vepron në kundërshtim me këto Terma dhe Kushte ose me legjislacionin në fuqi.

Në rast diskualifikimi, pjesëmarrësi humbet çdo të drejtë për përfitimin e çmimit.

8. Mbrojtja e të Dhënave Personale

Organizatori do të përpunojë të dhënat personale të pjesëmarrësve vetëm për qëllimet e administrimit të Garës, verifikimit të kushteve të pjesëmarrjes, përzgjedhjes së fituesve dhe komunikimit me ta.

Të dhënat personale nuk do të përdoren për qëllime të tjera pa pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

IutePay shpk
NIPT: M022090020

 Rr. "A.Z.ÇAJUPI" 1001 TIRANA
ND.3, H.2 ALBANIA

 **iute.al**
044 50 50 60

Përpunimi i të dhënave personale do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe politikat e privatësisë të Organizatorit.

9. Kufizimi i Përgjegjësisë

Organizatori nuk mban përgjegjësi për:

- Probleme teknike që mund të ndikojnë në pjesëmarrje;
- Gabime në të dhënat e dhëna nga pjesëmarrësit;
- Rrethana jashtë kontrollit të arsyeshëm të Organizatorit (forcë madhore).

10. Ndryshimi ose Anulimi i Garës

Organizatori rezervon të drejtën të modifikojë, pezullojë ose anulojë Garën në çdo kohë për arsye ligjore, teknike ose operacionale, duke njoftuar pjesëmarrësit nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit.

11. Pranimi i Termave dhe Kushteve

Pjesëmarrja në Garë nënkupton pranimin e plotë dhe pa rezerva të këtyre Termave dhe Kushteve.

12. Ligji i Zbatueshëm

Këto Terma dhe Kushte rregullohen dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me Garën do t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatave kompetente shqiptare.